



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS ME RASTIN E SHËNIMIT TË 5-VJETORIT TË
PAVARËSISË SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 SHKUR 2013**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA
POVODOM 5-GODIŠNJICE NEZAVISNOSTI KOSOVA, ODRŽANE
17. FEBRUARA 2013. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2013**

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

(Intonimi i Himnit të Kosovës)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare në Kosovë,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Shqipërisë,

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë në Kosovë,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Rifat Jashari,

Të nderuara familje të dëshmorëve,

Të nderuar miq dhe mysafirë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Kam kënaqësinë që me rastin e 5-vjetorit të pavarësisë së Kosovës ta hap këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Zonja dhe zotërinj

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë ta hap këtë mbledhje solemne të Kuvendit, në shënim të përvjetorit të pestë të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. Pas përpjekjes gati njëshekullore për liri dhe duke e mbyllur kapitullin historik të robërisë e të gjenocidit, Kosova më 17 shkurt 2008, në koordinim ndërkombëtar, u shpall shtet i pavarur, sovran dhe demokratik.

Pesë vjet s'mund të bëjnë veçse një jubile i vogël, por i një ngjarjeje të madhe dhe historike që po e shënojmë sot. Drejtësia e luftës dhe e përpjekjeve tona të gjata, idealet e larta që i udhëhoqën ato, i dhanë shumë shpejt legjitimitet ndërkombëtar pavarësisë së Kosovës, si shtet i ri, i lirë, sovran dhe demokratik. Shpallja e pavarësisë është njohur nga vendet lidere të demokracisë botërore dhe nga vende tjera mike, duke arritur gati numrin treshifror. Kosova ka subjektivitet ndërkombëtar, të bazuar edhe në të drejtën ndërkombëtare, e konfirmuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Pavarësia e Kosovës e përbën një fakt tashmë të pamohueshëm dhe të pakthyeshëm historik, politik e diplomatik.

Në historinë dhe jetën e një vendi, pesë vjet nuk janë aq shumë, por të arriturat dhe ndryshimet që ka bërë Kosova në epokën e pavarësisë janë të mëdha, sidomos drejt ngritjes së institucioneve shtetërore e demokratike, drejt fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar dhe zhvillimit të gjithanshëm shoqëror e ekonomik, sepse vetë akti i pavarësisë ka çliruar energji kolosale dhe entuziazëm veprimi e përparimi. Në Kosovë është vendosur rendi kushtetues që bazohet në parimet e lirisë, paqes e demokracisë. Kosova, me kushtetutë i ka sanksionuar sistemin politik demokratik, sovranitetin e popullit, pluralizmin politik dhe ekonomik.

Kuvendi ynë ka arritur me sukses të promovojë demokracinë e kulturën parlamentare dhe të sigurojë përfaqësimin e të gjitha komuniteteve pakicë.

Vendi ynë e përbën një faktor shumë të rëndësishëm paqëndrues dhe bashkëpunues në gjithë rajonin tonë. Kosova po i bashkon vlerat e saj me popujt e përparuar dhe demokratikë. Si rezultat i përparimeve të gjithanshme, Kosovës vitin e kaluar iu hoq mbikëqyrja ndërkombëtare e pavarësisë.

Megjithatë, duhet të jemi të ndërgjegjshëm se nuk e kemi asnjë arsye për vetëkënaqësi, duke pasur parasysh mundësitë dhe potencialet njerëzore e resurset e shumta natyrore të pashfrytëzuara, të cilat mund ta kishin vendosur vendin tonë gjatë kësaj periudhe në një stad më të lartë zhvillimi e përparimi.

Zonja dhe zotërinj

Vendi ynë, por edhe gjithë rajoni i Ballkanit Perëndimor ndodhen para sfidave të shumta historike në proceset paqëndruese, stabilizuese dhe integruese. Të dala nga një epokë vuajtjesh, diktaturash e luftërash të përgjakshme, vendet tona duhet të nxjerrin konkluzione të drejta mbi të kaluarën e hidhur, duke zëvendësuar urrejtjen ndëretnike e shovinizmin me respektin reciprok, etnocentrizmin me solidaritetin, ekskluzivitetin me integritet, mosdurimin nacional me diversitetin etnik, kulturor, gjuhësor e fetar, si pasuri vlerash demokratike. Ne nuk mund ta ndryshojmë as ta harrojmë historinë, por mund ta ndërtojmë bashkë një të ardhme tjetër, paqësore e në miqësi, për gjithë brezat e vendeve tona, duke lënë pas konfliktet dhe luftërat shkatërruese.

Kosova ndjek politikë të jashtme parimore, në funksion të bashkëpunimit e të marrëdhënieve miqësore bilaterale e multilaterale dhe të forcimit të paqes e të sigurisë në rajon dhe në planin global. Kosova gradualisht e ka forcuar subjektivitetin e saj ndërkombëtar, duke u pranuar anëtare e FMN-së, Bankës Botërore e BERZH-it dhe duke marrë pjesë në shumë forume rajonale e ndërkombëtare të bashkëpunimit. Por, Kosova ende nuk është pjesë e barabartë e projekteve dhe iniciativave të bashkëpunimit e të integritetit rajonale. Ajo, pa të drejtë mbahet jashtë Këshillit të Evropës, jashtë OSBE-së, jashtë IPU-së, por edhe jashtë Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Republika e Kosovës është gati t'i normalizojë marrëdhëniet, sikur me të gjithë fqinjët, edhe me Serbinë, por jo në dëm të integritetit territorial, të sovranitetit dhe të rendit kushtetues të vendit tonë.

Ne konsiderojmë që pakica kombëtare shqiptare në Serbi dhe pakica kombëtare serbe në Kosovë duhet t'i gëzojnë të drejtat të njëjta kombëtare dhe demokratike të nivelit evropian e ndërkombëtar dhe të shërbejnë si ura lidhëse e bashkëpunimi ndërmjet vendeve tona.

Ne kemi hyrë në dialog me Serbinë duke qenë të bindur se të dyja palët do të përfitojnë prej tij, por mbi të gjitha qytetarët tanë, duke e përmirësuar jetën e tyre të përditshme. Duke qenë ndërmjetësues në këtë dialog Bashkimi Evropian, shpresojmë që do të ushtrohet ndikim pozitiv mbi autoritetet serbe për të hequr dorë nga strukturat kriminale të instaluar në veri të Kosovës, për t'i hapur rrugë veprimit efikas të institucioneve tona e të EULEX-it dhe për të bërë të mundur zgjedhjen e përfaqësuesve nga vetë qytetarët atje.

Ne besojmë gjithashtu që Bashkimi Evropian, para se të pranojë në gjirin e tij vendet e Ballkanit Perëndimor, të vendosë si kusht zgjidhjen e të gjitha problemeve luftënxitëse dhe normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre, duke pamundësuar bllokimin e njëra-tjetrës në procesin historik të integrimit evropian.

Zonja dhe zotërinj

Objektivi historik i integriteteve euroatlantike të vendit tonë përbën strategjinë madhore dhe fokusin e gjithë veprimeve tona të koordinuara në vitet e ardhshme.

Duke qenë një ndërmarrje kaq e madhe dhe komplekse e gjithëpërfshirëse, integritet euroatlantike presupozojnë vënien në funksion dhe impenjimin e çdo institucioni e qelize shoqërore, angazhimin e të gjithë qytetarëve rreth një programi kombëtar, në një sistem veprimi të organizuar e të koordinuar institucionalisht, si mënyra e vetme për t'u realizuar aspiratat evropiane të popullit tonë dhe për t'i mposhtur të gjitha vështirësitë objektive dhe subjektive në të cilat ndodhet Kosova.

Para nesh është beteja e madhe e zhvillimit ekonomik, e zhdukjes së varfërisë, e zhvillimit demokratik dhe e sundimit të plotë të ligjit e të rendit në çdo pëllëmbë të Kosovës.

Deklarata e Pavarësisë, para pesë vjetësh, e përcaktoi të ardhmen demokratike dhe evropiane të Kosovës. Liria që kishte fituar Kosova më 1999 duhej institucionalizuar nëpërmjet instalimit dhe përsosjes së sistemit demokratik, si një proces i vazhdueshëm dhe pambarim.

Demokracinë ne e kemi kuptuar si realizim të lirisë për të gjithë, duke pranuar diversitetin në shoqëri dhe duke i respektuar vlerat e interesat e grupeve të ndryshme brenda saj.

Ashtu si në të kaluarën, Kosova do të jetë në partneritet të plotë me bashkësinë ndërkombëtare në synimin e saj për një shoqëri dhe shtet demokratik, të anëtarësuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara e në organizmat e tjerë ndërkombëtarë. Kosova është në proces të forcimit të sundimit të ligjit dhe në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke e pastruar rrugën drejt një shteti të vërtetë ligjor, demokratik dhe të integruar në Evropën e Bashkuar e në NATO.

Fitorja e luftës për vendosjen e rendit dhe ligjit, fitorja e luftës kundër krimit e korrupsionit, është njëkohësisht fitore e luftës kundër varfërisë e papunësisë, sepse vetëm kështu hiqen barrierat e investimeve dhe bizneseve, vetëm kështu hapet perspektiva ekonomike dhe sociale e Kosovës.

Një pengesë serioze për marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Evropian dhe subjektivitetin e saj ndërkombëtar përbën fakti i mosnjohjes së Republikës së Kosovës nga pesë vende të Bashkimit Evropian. Ne presim që edhe këto vende të reflektojnë për qëndrimet e tyre, duke i hapur vendit tonë mundësinë e zhvillimit normal të procesit të integriteteve evropiane.

Përsëritës në këtë rast thirrjen që u bëri këtyre vendeve Komisioni për Punë të Jashtme i Parlamentit Evropian që ta njohin pavarësinë e Kosovës.

Zonja dhe zotërinj

Sot në Kosovë do të ndalojë për një çast ora e historisë, e bashkë me të edhe ne, duke qëndruar të përkulur para kujtimit të dëshmorëve të lirisë. Ata janë përfaqësuesit historikë dhe të përjetshëm, shpirtërorë e moralë të brezave pa mbarim të kësaj toke të zhuritur. Përpjekjet shekullore të popullit tonë për liri e pavarësi do të realizoheshin vetëm duke u prirë nga vlera dhe virtyte të larta, të mishëruara në shpirtin e prijësve dhe dëshmorëve të Lëvizjes sonë Kombëtare dhe të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Sot është dita e dëshmorëve dhe e lirisë që na sollën me gjakun e tyre, dita e themeluesve, e baballarëve të shtetit të Kosovës, në krye me heroin legjendar, komandantin Adem Jashari. Lavdia e tyre, si gjerdan lirie do ta stolisë përjetë ballin e Kosovës.

Midis nesh në këtë sallë ndodhen përfaqësues diplomatikë të shumë vendeve mike të Republikës së Kosovës. Populli ynë mirënjohës kurrë nuk do ta harrojë solidaritetin e botës demokratike dhe humane, mbështetjen e pakursyer të miqve tanë të shtrenjtë, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n, në çastet më të vështira historike që po kalonte vendi ynë. Gjej këtë rast, që në emër të Kuvendit, qytetarëve që përfaqësojmë, dhe timin personalisht, t'u dërgoj përsëritësit vëllazërore dhe falënderimin e përjetshëm për gjithë mbështetjen dhe miqësinë që na dhanë e po na japin vende e popuj në katër anët e globit.

Zonja dhe zotërinj

Një popull që diti dhe pati forcë të rezistojë aq gjatë dhe të fitojë mbi errësirën, do të mund edhe t'i përballojë sfidat e brendshme e të jashtme drejt zhvillimit, përparimit dhe emancipimit e integritit në familjen e madhe euroatlantike. Shpirti i virtyteve të larta të traditës sonë dhe gërshtetimi me vlerat moderne evropiane e botërore do të shpërfaqet me gjithë madhështinë e tij në Kosovën e re, të lirë dhe demokratike.

Qytetarë të Kosovës,

Urime pesë vjetori i pavarësisë!

Paqja e mirëqenia zotëroftë me ju dhe me miqtë e Kosovës. Faleminderit!

(Duartrokitje)

E ftoj presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Atifete Jahjaga për një fjalë rasti.

(Duartrokitje)

ATIFETE JAHJAGA, PRESIDENTE E KOSOVËS: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar deputetë të Legjislaturës së vitit 2008, që e shpallët pavarësinë e Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, zoti Thaçi,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Qeverisë së Kosovës
I nderuar president i Republikës së Shqipërisë, zoti Nishani,
E nderuara kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonja Topalli,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,
Të nderuara familje të dëshmorëve dhe aktivistëve që kontribuan për
Kosovën e pavarur,
Të nderuar liderë të partive politike në Kosovë dhe në vende të rajonit,
Të nderuar udhëheqës të bashkësive fetare në Kosovë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Është një nder i madh për secilin prej nesh që prej këtu - prej këtij vendi - ku pesë vjet më
parë të zgjedhurit e popullit e kanë shpallur pavarësinë e Kosovës, ta shënojmë këtë ditë
historike, këtë vepër madhore të brezave të tërë.

Ta kremtojmë këtë akt të shpalljes së pavarësisë që e bëmë me miqtë tanë ndërkombëtarë,
Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e Bashkimit Evropian.

Prej këtu nis një kapitull i ri i historisë së shtetit më të ri në Evropë, me një të kaluar të
rëndë e përplot sakrifica, por me synimin për të qenë pjesë e barabartë e botës së
përparuar, një vend i begatë e i zhvilluar, i drejtë dhe i sigurt, për të cilin brezat e
ardhshëm do të jenë krenarë.

Shpallja e pavarësisë së një vendi nga ata që i përfaqësojnë qytetarët e tij është akti më
madhor, është vepra më fisnike dhe më e lartë. Ky është hap që e siguron të ardhmen e
qetë dhe të përparuar të qytetarëve të vendit dhe gjithsesi vendos bazën e zhvillimit e të
mirëqenies së tyre.

Historia e pavarësisë së shtetit tonë të përbashkët është e re. Ajo është pjesë e secilit
qytetar të Kosovës dhe e secilës gjeneratë. Është hap madhor në vendosjen e paqes dhe të
stabilitetit dhe në forcimin e sigurisë e të partneritetit, jo vetëm në rajon, por edhe më
gjerë.

Për më shumë, është hap konkret i mirëkuptimit ndërmjet nesh - qytetarëve të Republikës
së Kosovës.

Është shtet i miqësisë së përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe i
partneritetit me vendet e Bashkimit Evropian.

Në këto pesë vjet të shtetësisë, Republika e Kosovës i ka ngritur institucionet e saj
demokratike dhe funksionale, institucione gjithëpërfshirëse, me angazhim të
vazhdueshëm për mirëqenien e qytetarëve të vendit dhe për të ardhmen e tyre.
Konsolidimi i shtetit është thelbi i punës sonë dhe Kosova tashmë është shndërruar në
pjesë të pandashme të zhvillimeve ndërkombëtare.

Proceset në Kosovë janë të pakthyeshme dhe realiteti i shtetit tonë është bërë i njohur dhe
i pamohueshëm. Ligjshmëria e pavarësisë së Kosovës është vëltur me vendimin e

Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe me vazhdimin e njohjes së mëvetësisë së saj nga pothuaj gjysma e botës.

Dhe në këtë pesëvjetor, mëvetësia e shtetit tonë është bërë më e plotë me heqjen e mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe marrjes së përgjegjësisë për të gjitha çështjet nga vetë institucionet e qytetarët e Kosovës.

Ne kemi shumëçka për të treguar si një vend i ri - një histori suksesi e përbashkët edhe me faktorin ndërkombëtar, një shtet që po vendos bazat e demokracisë, duke i tejkaluar ngadalë problemet e tranzicionit.

Ky është shtet qytetar i kapaciteteve dhe mundësive të mëdha, shtet i të barabartëve - qytetarëve që me djersën dhe punën e tyre kanë ndërtuar çdo pjesë të këtij vendi - të vendit të tyre!

Kjo është e përbashkëta e Republikës së Kosovës - e njerëzve të saj që kanë sakrifikuar dhe po sakrifikojnë për ta ndërtuar një jetë më të mirë dhe më të begatë, një jetë të dinjitetshme si qytetarë të Evropës së Bashkuar.

Por, rruga e ndërtimit të shtetit është sa e vlefshme dhe e ndershme, po aq edhe e vështirë.

Në këtë pesëvjetor ne kemi shumë arsye për të festuar, por edhe më shumë punë për të bërë për t'i vendosur themelet e fuqishme të zhvillimit dhe të përparimit.

Shteti që po ndërtojmë bazohet mbi platformën e shtetit të së drejtës, ku sundimi i ligjit dhe rendi janë shtyllat themelore të tij. Ky shtet ligjor, me një sistem të reformuar të drejtësisë, do t'i hapë dyert e përparimit dhe të integritetit në familjen evropiane, si dhe do të ndihmojë zhvillimin e ekonomisë së tregut. Por, ne duhet ta thellojmë luftën tonë kundër dukurive negative, krimit të organizuar e korrupsionit dhe duhet të dëshmojmë se atë mund ta fitojmë.

Gjeneratat e ardhshme do të na gjykojnë në bazë të punës sonë të tashme dhe sukseseve që do të arrijmë. Ne kemi forcë dhe aftësi, kemi guxim për ta fituar luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kjo është beteja për shtetin tonë dhe për të ardhmen e tij.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Bashkimi Evropian është synim yni. Kjo është alternativa e vetme që kemi dhe rruga drejt tij është e pandalshme dhe e pamohueshme. Perspektiva jonë e integritetit evropian është e qartë dhe atë do ta kalojmë të gjithë së bashku - ne qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kjo është e përbashkëta e të gjithë neve, pa dallim, dhe ky është qëllimi ynë.

Ne kemi dëshmuar se jemi faktor i paqes dhe stabilitetit. Kemi dëshmuar se jemi promotor të fqinjësisë së mirë dhe promovues të vlerave demokratike. Shtet që e respekton sovranitetin e të tjerëve dhe që e kërkon vendin e merituar në Bashkimin Evropian, në mesin e popujve të lirë e të barabartë. Rruga drejt familjes evropiane, e të gjithë neve, shteteve të vogla të Ballkanit Perëndimor do të jetë më e lehtë dhe më e sigurt vetëm duke e ndihmuar njëri-tjetrin.

Zgjidhjet i kemi kërkuar vetëm nëpërmjet dialogut, si mënyra më e mirë për të arritur rezultatet që bazohen në përvojat dhe standardet evropiane dhe që e respektojnë integritetin e secilit shtet. Zgjidhjet po i kërkojmë për të mirën e qytetarëve tanë, për lehtësimin e jetës së tyre dhe për një të ardhme më të mirë.

Dialogut nuk i frikësohemi dhe kemi hyrë në të me vullnetin për ta përfunduar më shpejt një kapitull të rëndë të marrëdhënieve të vështira me Republikën e Serbisë. Dialogu nuk po zhvillohet për ta ndarë Kosovën, as për të krijuar enklava të veçanta të askujt, as autonomi e statuse të posaçme. Të gjitha zgjidhjet janë brenda Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës dhe me standarde evropiane.

Respekti i ndërsjellë, si dy shtete sovrane e të pavarura, do të na ofrojë më shumë me Bashkimin Evropian dhe do ta zbehë kundërshtinë ndërmjet nesh.

Historinë nuk mund ta zhbëjmë, por le ta ndërtojmë të tashmen në paqe, për hir të së ardhmes.

Republika e Kosovës është realitet i pamohueshëm. Një proces i pakthyeshëm. Vullnet i realizuar i qytetarëve të saj. Një tërësi tokësore e pandashme dhe e garantuar ndërkombëtarisht. Republika e Kosovës është shtet i të gjithë atyre që jetojnë në kufijtë e saj, pa dallim, shtet i bazuar në parimin qytetar, me të drejta dhe liri të garantuara, por edhe me përgjegjësi për secilin.

Oferta për secilin qytetar është e thjeshtë dhe e qartë - shteti ynë është i përbashkët dhe atë do ta ndërtojmë për të mirën tonë. Për të mirën edhe të atyre qytetarëve tanë në komunat në veri të Kosovës, jeta e të cilëve vazhdon të mbetet peng i grupeve të caktuara. Vendorsja e sundimit të ligjit dhe e rendit në pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës është thelbësore për zhvillimin e saj në kuadër të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit dhe për qetësinë, sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve tanë të komunitetit serb.

Alternativa jonë është e përbashkët - në kuadër të shtetit të Kosovës, me të drejta të barabarta dhe të pamohueshme për secilin qytetar dhe me lirinë e garantuar për ta. Kufijtë nuk do të ndryshojnë. Dialogu me qytetarët tanë të secilit komunitet, por edhe të komunitetit serb, posaçërisht atij në pjesën veriore të Republikës së Kosovës, si mënyra më e mirë e zgjidhjes së problemeve, do të mundësojë ecjen përpara.

Nezavisnost Kosova je vaša nezavisnost. Budućnost se gradi zajedno sa svim drugim

građanima Kosova. Ova je i vaša domovina za koju ćete biti ponosni. Dajte da pružimo ruku saradnje da izgradimo sadašnjost u miru zarad budućnosti.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kjo festë e pesëvjetorit le të na bëjë bashkë. Ta ndajmë këtë gëzim ndërmjet nesh, me miqtë tanë që na kanë ndihmuar në çdo hap, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Bashkimin Evropian, duke e kujtuar secilin që ka sakrifikuar e punuar për të tashmen tonë. Le të tregojmë se ne jemi qytetarë që e ndërtojmë pa frikë të ardhmen - të sigurt dhe në paqe me të gjithë.

Kjo është dita jonë, të cilën do ta gazojmë së bashku dhe për të cilën ndihemi krenarë.

Zoti ju bekoftë!
Zoti e bekoftë Kosovën dhe miqtë e saj! Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: E ftoj kryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonjën Jozefina Topalli, për fjalë rasti.

(Duartrokitje)

JOZEFINA TOPALLI, KRYEPARLAMENTARE E SHQIPËRISË:

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,
Zoti kryeministër Thaçi,
Zonja presidente Jahjaga,
Zoti president Nishani,
Të nderuar deputetë,
Vëllezër e motra,
Gëzuar festën! Gëzuar festën tonë, gëzuar festën tuaj, gëzuar 5-vjetorin e pavarësisë!

Unë jam shumë e lumtur që jam këtu dhe kam mundësinë të flas përpara këtij Parlamenti të Kosovës së lirë, të pavarur e demokratike.

Kolegë të dashur,
Anëtarë të Parlamentit,
Nderi është edhe më i madh, sepse bashkohem me ju në këtë ditë të madhe, historike për të festuar 5-vjetorin, ditëlindjen më të bukur të Kosovës.

Për të arritur në Kosovën e lirë, të pavarur, ju shqiptarët këtu, prindërit tuaj, gjyshërit tuaj jeni ngritur, keni luftuar, keni sakrifikuar si askush tjetër.

Në këto 150 vjetët e fundit, apo në 100 vjetët e fundit, apo edhe në 50 vjetët e fundit, edhe në 15 vjetët e fundit, ju nuk u nënshtuar kurrë dhe nuk u ndalët asnjëherë, shqiptarët këtu, shqiptarët në Shkup, shqiptarët në Mal të Zi, shqiptarët në Shqipëri nuk e

humbën kurrë besimin, nuk e shuan kurrë shpresën, edhe pse të copëtuar, edhe pse nën pushtim, edhe pse nën diktaturë, edhe pse dukej e pamundur për shqiptari dhe për liri.

E sot, i nderojmë paraardhësit tanë. Ata që e bënë Lidhjen e Prizrenit, ata që u ngritën, që filluan, organizuan e bënë kryengritje të mëdha. Ata bënë aq shumë për Shqipërinë e lirë e të mosvarme.

Pa të madhin Hasan Prishtina, pa Isa Boletinin, apo Robin Hudin shqiptar, Shqipëria ndoshta nuk do t'i kishte 100 vjet pavarësi, e pa këtë të fundit vështirë të ishim sot duke kremtuar së bashku.

Kosova është djepi i shqiptarisë dhe për këtë, në emër të Kuvendit të Shqipërisë, dua ta falënderoj Kosovën dhe shqiptarët e Kosovës.

(Duartrokitje)

Sot e nderojmë çdo shqiptar në Kosovë, çdo familje në Kosovë që kombin e lirinë i kishin sublime, i kishin më të shtrenjtë se jetën e tyre, më të çmuar se pasurinë e tyre, më të madhe se çdo ëndërr të tyre. Ndaj, edhe me përulje e mirënjohje sot kujtojmë, e nderojmë presidentin e parë të Kosovës Ibrahim Rugovën, arkitektin e Kosovës së pavarur.

(Duartrokitje)

Nderojmë besimin e tij të palëkundur te paqja, përkushtimin, punën, maturinë, vendosmërinë për lirinë, për Kosovën. Sot e nderojmë veprën e tij.

Në këtë ditë historike, e nderojmë luftën çlirimtare të Kosovës, luftëtarët e lirisë, martirët e shumë të saj, e mbi të gjithë legjendën shqiptare të saj - Adem Jasharin.

(Duartrokitje)

Ai është vetë shqiptaria! Zjarri i dashurisë dhe i flijimit për këtë tokë, për këtë dhe, për këtë komb - i përjetshëm kujtimi i tij.

Faleminderit çdo shqiptari në Kosovë, çdo shqiptari kudo në trojet shqiptare, apo nëse jeton sot në Zvicër, në Gjermani, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo në Britani - gëzuar festën të gjithë bashkë!

Sot, të gjithë bashkë festojmë 5 vjet Kosovë të lirë e të pavarur. Sot gëzojmë ëndrrën shekullore, sot e kremtojmë lirinë e gjithë kombit tonë.

Gëzuar të gjithë shqiptarëve!

Faleminderit Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të gjitha atyre vendeve të Bashkimit Evropian që 14 vjet më parë bënë luftën e drejtë për t'i mbrojtur të drejtët.

Mirënjohje Bill Klintonit, Toni Blerit! Ju ishit të parë që u ngritët e na dolët zot!

Mirënjohje Xhorxh Bushit, që më 2007 nga Tirana, bashkë me kryeministrin Sali Berisha, paralajmëruat njohjen e pavarësisë së Kosovës, e cila pas një viti u bë realitet.

Edhe pse ne shqiptarët mund t'i gjejmë rrënjët e historisë sonë në mijëra vjet më përpara, ne në fakt shikojmë vetëm përpara, edhe sot në këtë ditë feste.

Ne nuk e festojmë vetëm 5-vjetorin e pavarësisë së Kosovës së lirë, ne nuk e festuam vetëm 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë së dashur. Ne i kremtojmë ndryshimet e mëdha që i ka bërë Kosova. Ndryshimet e mëdha që i ka arritur Shqipëria. Asnjë komb nuk ka bërë një rrugë kaq të vështirë, në një kohë kaq të gjatë sa kombi ynë për të mbërritur tek e mrekullueshmja, që e ka emrin Liri. Por, edhe asnjë komb tjetër nuk ka bërë një rrugë kaq të gjatë për një kohë kaq të shkurtër, pas fitimit të lirisë, siç bën Shqipëria dhe Kosova.

Ne jemi shqiptarë, të gjithë njëloj. Ne ia dalim! Ne ia kemi dalë! Ne besojmë te Liria. Ajo është magjia që i bën gjërat të funksionojnë, por edhe ne, si amerikanët, pyesim veten çdo ditë ç'mund të bëjmë edhe më shumë.

Siç tha Hilari Klinton në Parlamentin shqiptar për 100-vjetorin e pavarësisë, ne e kemi potencialin të bëhemi model, jo vetëm për rajonin, jo vetëm për Evropën, por edhe për botën.

Ne jemi një komb i ri, plot energji e plot shpresë. Ne jemi një popull multi-religjioz. Ne jetojmë në harmoni ndërmjet besimeve fetare. Ne i respektojmë besimet e njëri-tjetrit. Kjo është një pasuri unike e kombit shqiptar, kudo që jeton.

Ky është qytetërim. Ky e ka emrin civilizim! Civilizimi më i vjetër dhe më i vyer që ekziston.

Faleminderit paraardhësve që na e lanë këtë trashëgimi të mrekullueshme, e që ne sot e ruajmë me aq shumë xheloz.

Kjo është një dhuratë e çmuar dhe ne duhet ta vlerësojmë atë. Por, edhe të gjithë bashkë ta përdorim edhe si argument, edhe me të tjerët, në favor të shqiptarizmit, në favor të unikalitetit të kombit tonë. Ne jemi krenarë që jemi shqiptarë, e krenarë që jemi evropianë. Ne duam t'i bashkohemi komunitetit evropian, të ngritur mbi vlerat universale. Ne të gjithë bashkë e kemi vetëm një objektiv: një komb - një qëndrim, është besimi ynë. Një komb - një qëndrim, ishte motoja jonë në ditë të vështira. Një komb - një qëndrim, është aktual sot. Një komb - një qëndrim, do të jetë për jetë të jetëve. Dhe ne duam të integrohemi në Bashkimin Evropian. Ne duam të bashkohemi me njëri-tjetrin dhe ne duam të bashkohemi me familjen evropiane. Ne do të vazhdojmë ta bëjmë punën e madhe që kërkohet për të hyrë në këtë komunitet - ne në Shqipëri, ju në Kosovë, shqiptarët në Maqedoni, shqiptarët në Mal të Zi.

Ne shqiptarët jemi një faktor konstruktiv, model i paqes, i lirisë, i vullnetit e punës për t'u integruar, model për fqinjësinë e mirë me vendet që na rrethojnë. Kurrë nuk e kemi sulmuar një vend tjetër. E kundërta, ka ndodhur.

Ky është vullneti ynë i përbashkët, i të gjithë ne shqiptarëve. Ne shqiptarët dimë të rrokim mundësi të lirisë dhe të dhuratës së paçmuar të demokracisë. Ne dimë t'i përqafojmë mundësitë e shekullit që ne i kemi përpara.

Po të ishte gjallë poeti kombëtar Gjergj Fishta, besoj se sot do të këndonte:

Edhe hëna do ta dijë
Edhe dielli do të ketë pa,
Se për qark kësaj rrokullie
Si shqiptarët një komb nuk ka

(Duartrokitje)

Zoti e bekoftë Kosovën!
Zoti e bekoftë Shqipërinë!
Zoti e bekoftë kombin shqiptar!
Faleminderit të gjithëve!
Gëzuar festën!

(Duartrokitje)

KRYETARI: E falënderojmë kryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonjën Jozefina Topalli, për fjalën tepër të ngrohtë. Tani fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, për një fjalë rasti.

(Duartrokitje)

HASHIM THAÇI, KRYEMINISTËR I KOSOVËS: E nderuara presidente e Kosovës, zonja Jahjaga,
I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve dhe të politikës nga Shqipërisë,
I nderuari president Nishani,
E nderuar kryeparlamentare Topalli,
I nderuari kryetar Rama,
Të nderuar përfaqësues dhe lider të partive politike nga Maqedonia, Presheva, Mali i Zi, Shqipëria e partive tjera dhe të gjitha vendeve tjera të rajonit,
Të nderuar ambasador të pranishëm në këtë seancë,
Të nderuar deputetë edhe të mandatit të kaluar, edhe aktualë,
Kabinet qeveritar,
Të nderuara familje të dëshmorëve,
Zonja dhe zotërinj,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Para pesë vjetësh, këtu, në këtë Kuvend, u kurorëzua dinjitetshëm ëndrra shekullore e qytetarëve tanë, shpallja e pavarësisë së Kosovës.

Më 17 shkurt 2008 u themelua shteti i Kosovës me aktin më të lartë historik, juridik dhe politik, me Deklaratën e Pavarësisë, pra Kosova shtet i pavarur dhe sovran.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës e aprovuan dokumentin më të rëndësishëm historik të Kosovës.

Më lejoni t'i përshëndes deputetët firmëtarë të pavarësisë. Pavarësinë e Kosovës, para së gjithash, e firmosën dhe e vulosën dëshmorët e lirisë, sakrifica e gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Më 17 shkurt 2008 në gjeografinë politike të Evropës lindi një shtet i ri.

Më 17 shkurt 2008, Kosova e mori atributin më të lartë të organizimit politik, krijimin e shtetit të pavarur.

Më 17 shkurt 2008, Kosova e institucionalizoi organizimin më të lartë shoqëror, shtetësinë e saj.

Zonja dhe zotërinj,

Ky akt madhështor, origjinal dhe i papërsëritshëm i vullnetit të popullit ishte kryevepër e synimeve, idealeve, përpjekjeve dhe sakrificave të vazhdueshme të gjeneratave të tëra.

Por, këtë akt të jashtëzakonshëm e bëri madhështor fakti që u njoh, u mbështet dhe u përkrah nga shtetet më të rëndësishme të demokracisë botërore.

Pavarësia e Kosovës u njoh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga shumica e shteteve të Bashkimit Evropian dhe shtetet tjera të botës demokratike.

Pesë vjet më parë Kosova e tregoi cilësitë e qytetarisë dhe vlerat e saj të larta kombëtare dhe demokratike.

Kosova me shekuj ishte radhitur nga ana e lirisë, nga ana e qëndresës, dhe në një moment po zyrtarizohej gjithçka.

Prandaj, sot shprehim nderim institucional dhe respekt të thellë për nënat, baballarët, motrat, vëllezërit, prindërit, të rinjtë e të rejtat, pleqtë dhe fëmijët që ranë për lirinë e Kosovës.

Nderojmë të gjithë qytetarët që kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. E nderojmë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E nderojmë rezistencën gjithëqytetare.

E çmojmë, e nderojmë dhe e respektojmë jetën dhe veprën e komandantit legjendar

Adem Jashari. E çmojmë, e vlerësojmë e nderojmë jetën dhe veprën e presidentit Ibrahim Rugova.

Të nderuar të pranishëm,

Meritorë për pavarësinë e Kosovës janë të gjithë qytetarët e Kosovës. Prandaj, sot çdo qytetar i Kosovës, kudo që jeton, duhet të ndihet mirë dhe krenar me sakrificën e tij.

Një mirënjohje të lartë ia drejtojmë sot diasporës sonë, kudo që është, në vendet e Bashkimit Evropian, apo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Zonja dhe zotërinj,

Pavarësia e Kosovës është kurorëzim i vullnetit gjithëpopullor dhe vizionaritet për realizimin e shtetkrijimit.

Lufta e drejtë dhe orientimi vizionar për çlirim bëri që Kosova ta ketë mbështetjen e fuqishme të botës së përparuar dhe demokratike.

Bota ishte e pranishme në Kosovë dhe ishte dëshmitare e historisë së botës demokratike. Kosova ishte e pranishme në botë, ishte në krah të kombeve dhe shteteve të lira. Bota demokratike e mbështeti Kosovën në betejën për liri dhe pavarësi.

Ky orientim bëri që Kosova të jetë fitimtare morale, politike dhe ushtarake, duke u çliruar njëherë dhe përgjithmonë nga sundimi i huaj.

Me një vizion të qartë, të orientuar nga vlerat e demokracisë perëndimore, Kosova u mbështet dhe u përkrah edhe në periudhën e tranzicionit demokratik, që përgatiti parakushtet për shpalljen e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran.

Ky orientim dhe drejtësia e çështjes së Kosovës bëri që të fitohet beteja juridike edhe në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, mbi ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Prandaj, sot, në pesëvjetorin e pavarësisë shprehim mirënjohje të thellë për miqtë tanë, për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian, NATO-n dhe gjithë botën demokratike, që e ndihmoi dhe e përkrah Kosovën, e që vazhdon ta ndihmojë edhe sot.

Zonja dhe zotërinj,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Brenda një periudhe pesëvjeçare Kosova ka shënuar hapa të rëndësishëm në konsolidimin e institucioneve.

Që nga shtatori i vitit që shkoi, Kosova e hoqi mbikëqyrjen e pavarësisë suksesshëm, duke u bërë shtet me përgjegjësi të plotë për veten dhe ardhmërinë e saj.

Kosova e hoqi mbikëqyrjen pas një vlerësimi të lartë gjithë ndërkombëtar për suksesin në

Kosovë. Kjo është meritë e të gjithëve, e gjithë skenës politike dhe e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo dëshmon se historia e Kosovës është një histori e suksesshme kosovare dhe gjithëndërkombëtare.

Që nga periudha e pasluftës e deri tani, Kosova, nga miqtë e saj, me të drejtë konsiderohet si histori e suksesshme e shtetndërtimit.

Brenda një periudhe të shkurtër, Kosova ka shënuar rezultate të lakmueshme në të gjitha fushat.

Kosova ka shënuar rritje ekonomike dhe zhvillim të infrastrukturës, duke e përmirësuar standardin e jetesës për të gjitha kategoritë shoqërore.

Kosova është njohur nga rreth 100 shtete. Presim shumë shpejt edhe njohje të reja.

Zonja dhe zotërinj,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Brenda një periudhe 14-vjeçare, Kosova iredizoi dy objektiva të mëdhenj historikë: çlirimin, pra lirinë, dhe pavarësinë e saj.

Kosova, mbi të gjitha, është shtet që prodhon paqe, fqinjësi të mirë dhe stabilitet në rajon.

Kosova, me ndërmjetësimin dhe udhëheqjen e Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka nisur procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë, me besimin që së shpejti pavarësia e Kosovës të njihet edhe nga ky vend fqinj.

Kosova është në rrugë për përmbushjen e kriterëve për t'u anëtarësuar në institucionet euroatlantike, në Bashkimin Evropian, në NATO, dhe në rrugën drejt anëtarësimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Natyrisht, në tërë këtë proces të integritimeve, Kosova do të ballafaqohet me sfida, por jam i bindur se politika kosovare, bashkërisht dhe në koordinim të ngushtë me miqtë ndërkombëtarë do t'ia arrijë t'i realizojë këto synime.

Në pesëvjetorin e pavarësisë, Kosova e re, evropiane, shumetnike, është shtet me perspektivë të sigurt për të gjithë qytetarët e saj, atdhe i të gjithë qytetarëve të saj, shqiptarëve, serbëve, turqve, boshnjakëve, malazezve, kroatëve, romëve dhe të gjitha komuniteteve që jetojnë këtu.

Edhe njëherë, urime Dita e Pavarësisë së Kosovës! Urime!

(Duartrokitje)

KRYETARI: E falënderojmë kryeministrin për fjalën e tij.
Të nderuar të pranishëm,

Ju falënderoj përzemërsisht për pjesëmarrjen tuaj në festën tonë. Këtu i përmbysim punimet e seancës solemne, të organizuar me rastin e pesëvjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Mirupafshim në seancat tjera dhe në përvjetorët tjerë!

(Duartrokitje)

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë